

3/15/2023

# PASQYRAT FINANCIARE

PER VITIN E MBYLLUR USHTRIMOR 31.12.2022

*ENER TRADE shpk*

*NIPT: L82118017S*

*Rruga e Elbasanit, Objekti Park Gate, Tirane*

**PASQYRA E PERMBAJTJES**

<b>V- SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE</b> .....	7
1. <b>Informacion i pergjithshem</b> .....	7
2. <b>Aplikimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar te reja dhe te rishikuara (SNRF)</b> .....	7
2.1. <b>Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale</b> .....	7
2.2 <b>Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te pa pervesuara</b> .....	8
3. <b>Bazat e pergatitjes se pasqyrave Financiare</b> .....	8
3.5.1. <b>Zhvleresimi i llogarive to arketueshme</b> .....	9
3.5.2. <b>Provizionet</b> .....	9
3.5.3 <b>Zhvleresimi i inventareve</b> .....	9
3.6 <b>Politikat Kontabel</b> .....	10
3.6.1. <b>Transaksionet ne monedhe te huaj</b> .....	10
3.6.2. <b>Instrumentat financiare</b> .....	10
4. <b>Kapitali aksionar</b> .....	12
4.1. <b>Inventaret</b> .....	12
4.2. <b>Aktive afatgjata materiale</b> .....	12
4.3. <b>Aktivet afatgjate jo-materiale</b> .....	13
4.4. <b>Aktivet jo-financiare</b> .....	13
4.5. <b>Kosto e huamarrjes</b> .....	14
4.6. <b>Te ardhurat</b> .....	14
4.7. <b>Te ardhurat e tjera nga shfrytezimi</b> .....	14
4.8. <b>Qirate</b> .....	14
4.9. <b>Te ardhurat dhe shpenzimet financiare</b> .....	14
4.10. <b>Tatimi mbi fitimin</b> .....	14
4.11. <b>Perfitimet e punonjesve</b> .....	15
4.12. <b>Transaksionet me pale e lidhura</b> .....	15
4.13. <b>Provizionet</b> .....	15
4.14. <b>Aktivet dhe detyrimet e kushtezuara</b> .....	15
5. <b>Aktivet Afatgjata</b> .....	16
5.1. <b>Aktivet Afatgjata Materiale</b> .....	16
6. <b>Aktivet Afatshkurtra</b> .....	17
6.1 <b>Inventare</b> .....	17

6.2. Llogari te arketueshme tregtare.....	18
6.3. Parapagime te dhena per blerje energjie.....	18
6.4. Llogari te arketueshme te tjera .....	19
6.5. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.....	19
6.5.1.1 Arka .....	20
6.5.2. Fondet e mbajtura per garanci bankare.....	20
7. KAPITALET E VETA.....	20
8. Detyrimet Afatgjata.....	21
9. Detyrimet Afatshkurtra .....	21
9.1. Huate afatshkurtra .....	21
9.2. Parapagime te marra per shitje energji elektrike.....	22
9.3. Te pagueshme ndaj furnitoreve.....	22
9.4. Detyrime tatimore.....	22
10. Te ardhurat nga shitja.....	22
11. Shpenzime te Shfrytezimit .....	23
12. Fitimi operativ.....	24
13. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare.....	24
14. Rezultati financiar.....	24
15. Transaksionet me palet e lidhura.....	25
16. Manaxhimi i riskut financiar.....	25
17. Vlera e drejte e instrumentave financiare .....	26
18. Ngjarje pas dates se raportimit financiar .....	26



**Pasqyrat Financiare ENER TRADE shpk per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022**

(ne Leke)

**ENER TRADE SHPK**

**I.- Pasqyra e Pozicionit Financiar per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022**

Nr	Pershkrimi	Shenime	Mbyllur me	Mbyllur me	Mbyllur me
			31/12/2022	31/12/2021	31/12/2020
	<b>AKTIVET</b>				
	<b>Aktivete Afatgjata</b>				
1	Aktivete afatgjata materiale		33,947,049	34,032,955	8,082,438
2	Aktivete afatgjata financiare , Pjesmarrje		7,353,605	7,768,260	
3	Aktivete afatgjata jomateriale		555,510	748,125	853,097
	<b>Totali</b>		<b>41,856,164</b>	<b>42,549,341</b>	<b>8,935,535</b>
	<b>Aktivete afatshkurtra</b>				
1	Inventare , Parapagime per furnizim				
2	Llogari te arketueshme tregtare Kliente		3,034,734,354	2,109,465,015	1,167,846,369
3	Parapagime te dhena		1,241,003,300	954,727,592	
4	Llogari te arketueshme te tjera		221,950,672	194,147,926	250,410,709
5	TVSH e zbritshme, etj		812,832,605	503,767,220	
6	Mjete monetare ne arke dhe banke		538,693,309	499,277,533	32,598,332
7	Te ardhura te llogaritura			60,426,879	
	<b>Totali</b>		<b>5,849,214,240</b>	<b>4,321,812,165</b>	<b>1,450,855,410</b>
	<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>5,891,070,404</b>	<b>4,364,361,506</b>	<b>1,459,790,945</b>
	<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>				
1	Kapitali aksionar		40,000,000	40,000,000	100,000
2	Rezerva ligjore		3,019,791	3,019,791	19,791
3	Rezerva te tjera		896,253,210		
4	Fitime/humbje te mbartura				
5	Fitime/humbje te ushtrimit		1,394,476,864	1,084,491,379	84,721,523
	<b>Totali i kapitalit</b>		<b>2,333,749,865</b>	<b>1,127,511,170</b>	<b>84,841,314</b>
	<b>DETYRIMET</b>				
	<b>Detyrimet afatgjata</b>				
1	Hua afatgjata		8,478,940	8,984,786	427,638,820
2	Grante Te ardhura te shtyra etj				
	<b>Totali</b>		<b>8,478,940</b>	<b>8,984,786</b>	<b>427,638,820</b>
	<b>Detyrime afatshkurtra</b>				
1	Hua afatshkurtra bankare		560,697,603	1,267,221,068	813,809,224
2	Hua afatshkurtra te tjera		87,915,477	423,867,600	
3	Llogari te pagueshme (furnitore)		1,846,599,510	821,690,291	63,497,705
4	Parapagime te marra		959,337,933	536,505,442	
5	Detyrime tatimore		94,291,074	113,092,026	10,233,682
6	Llogari te pagueshme te tjera			5,062,244	59,770,199
	<b>Totali</b>		<b>3,548,841,597</b>	<b>3,227,865,550</b>	<b>947,310,810</b>
	<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>3,557,320,538</b>	<b>3,236,850,336</b>	<b>1,374,949,631</b>
	<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>5,891,070,403</b>	<b>4,364,361,506</b>	<b>1,459,790,945</b>

Pasqyrat financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri ne 28, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

**ADMINISTRATORI**

ARBEN MARGILAJ

*(Arben Margilaj)*

**Hartues i pasqyrave financiare**

AURORA CULLUFE

*(Aurora Cullufe)*



**Pasqyrat Financiare ENER TRADE shpk per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022**

(ne Leke)

**ENER TRADE SHPK**

**II.- Pasqyra e Fitim (Humbje)dhe te Ardhurave Gjitheperfshirese per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022**

Nr	Perskrimi	Mbyllur me	Mbyllur me	Mbyllur me
		31/12/2022	31/12/2021	31/12/2020
<b>TE ARDHURAT</b>				
1	Te ardhura nga shitja	41,864,809,577	15,518,236,051	2,173,715,270
2	Te ardhura te tjera	2,625,005.00		
3	Autofaturime	881,787,293	1,950,939,002	
	<b>Totali</b>	<b>42,749,221,875</b>	<b>17,469,175,053</b>	<b>2,173,715,270</b>
<b>SHPENZIMET</b>				
1	Blerje Mallra e kapacitete per rishitje	(39,878,885,505)	(14,130,663,019)	(2,038,233,552)
2	Kosto e punes	(19,295,255)	(13,783,986)	(3,190,598)
3	Zhvleresimi dhe amortizimi	(8,674,874)	(6,013,321)	(676,199)
4	Shpenzime te tjera	(204,745,079)	(46,990,564)	(21,401,695)
4	Autofaturime	(881,787,293)	(1,950,939,002)	
	<b>Totali</b>	<b>(40,993,388,006)</b>	<b>(16,148,389,892)</b>	<b>(2,063,502,044)</b>
	<b>Fitimi operativ</b>	<b>1,755,833,868</b>	<b>1,320,785,161</b>	<b>110,213,226</b>
<b>Te ardhura/shpenzime financiare</b>				
1	Interesa Neto	(57,112,458)	(32,835,046)	(10,704,998)
2	Kembimi valutor neto	(89,816,294)	(11,773,674)	290,378
3	Te Tjera			
	<b>Totali</b>	<b>(119,991,900)</b>	<b>(44,608,720)</b>	<b>(10,414,620)</b>
	<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,635,841,968</b>	<b>1,276,176,441</b>	<b>99,798,606</b>
1	Tatimi i shtyre			
2	Shpenzim Tatim Fitimi	(241,365,104)	(191,685,062)	(15,077,083)
	<b>Fitimi Neto</b>	<b>1,367,540,012</b>	<b>1,084,491,379</b>	<b>84,721,523</b>
1	Te ardhura te tjera gjitheperfshirese	26,936,853	-	-
2	Fitimi nga kompani meme	-	-	-
	<b>Totali i te ardhurave gjithe perfshirese</b>	<b>1,394,476,864</b>	<b>1,084,491,379</b>	<b>84,721,523</b>

Pasqyrat financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri ne 28, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

**ADMINISTRATORI**

**ARBEN MARGILAJ**

*(Arben Margilaj)*  
*(Arben Margilaj)*



**Hartues i pasqyrave financiare**

**AURORA CULLUFE**

*(Aurora Cullufe)*  
*(Aurora Cullufe)*

ENER TRADE SHPK

III.- Pasqyra e ndryshimeve ne Kapital per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022

Pershkrimi	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim/humbja e vitit financiar	Totali
<b>Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2020</b>	100,000				100,000
Transaksionet me pronaret					0
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2020		19,791		84,721,523	84,741,314
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2020</b>				<b>84,721,523</b>	84,721,523
Miratimi i rezultatit 31.12.2020				<b>-84,721,523</b>	-84,721,523
<b>Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2021</b>	<b>100,000</b>	<b>19,791</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	119,791
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2021				1,084,491,379	1,084,491,379
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2021</b>	<b>100,000</b>	<b>19,791</b>	<b>0</b>	<b>1,084,491,379</b>	1,084,611,170
Miratimi i rezultatit 31.12.2021	39900000	3000000		<b>1,084,491,379</b>	1,127,391,379
<b>Pozicioni i rideklaruar ne 1 janar 2022</b>	<b>40,000,000</b>			1,084,491,379	1,124,491,379
Transaksionet me pronaret				(188,238,170)	-188,238,170
Fitimi (humbje) neto per periudhen kontabel 2022				1,394,476,864	1,394,476,864
<b>Pozicioni me 31 Dhjetor 2022</b>	<b>40,000,000</b>	<b>3,019,791</b>	<b>0</b>	<b>2,290,730,073</b>	2,333,749,864

Pasqyrat financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri ne 28, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

Administratori

Hartues i pasqyrave financiare

ARBEN MARGILAJ

AURORA CULLUFE

*(Arben Margilaj)*

*(Aurora Cullufe)*



**ENER TRADE SHPK**  
**IV.- Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022**

Nr	Pershkrimi	Mbyllur me	Mbyllur me	Mbyllur me
		31/12/2022	31/12/2021	31/12/2020
	<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>			
1	<b>Fitimi para tatimit</b>	1,635,841,968	1,276,176,441	99,798,606
	Rregullime per	0	0	
1	Amortizimi	8,674,874	6,013,321	676,199
2	Zhvleresim i llogarive te arketueshme	0	0	
3	Efekte nga kursi i kembimit	0	0	
4	Efekte nga tatimi i fitimit	-241,365,104	-191,685,062	-15,077,083
5	Te ardhura nga grantet e subvencionet	0	0	
6	Vlera kontabel e AA te shitura	0	0	
7	Efektet e e tatimit te shtyre	0	0	
	<b>Levizjet e Kapitali qarkullues</b>			
8	Rritje(-), renie(+) teprica e kerkesave per arketim	-1,487,986,298	-2,404,277,554	-1,317,023,749
9	Rritje(-), renie(+) teprica e shpenz per tu shperndare			
10	Rritje(-), renie(+) teprica e furnitoreve	1,447,741,710	1,294,698,028	63,418,703
11	Rritje(-), renie(+) teprica e llog. tjera te pagueshme	-65,489,123	882,998,368	59,753,649
12	Rritje(-), renie(+) ne marredheniet me buxhetin	-18,800,952	102,858,344	9,402,701
	<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytezimit</b>	<b>1,278,617,076</b>	<b>966,781,886</b>	<b>-1,099,050,974</b>
	<b>Fluksi monetar nga veprimtarite investuese</b>			
1	Arketime/Pagesa per blerjen e investimeve te tjera			
2	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-7,981,697	-39,627,127	-8,594,391
3	Rivleresimi i asetave			
3	Te ardhura nga shitja e paisjeve			
4	<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet investuese</b>	<b>-7,981,697</b>	<b>-39,627,127</b>	<b>-8,594,391</b>
	<b>Fluksi monetar nga veprimtari financiare</b>			
1	Hua te arketuara /paguara (Neto)	-1,042,981,434	-418,654,033	1,132,433,696
2	Dividente te paguar	-188,238,169	-41,821,522	-4,780,000
	<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet financiare</b>	<b>-1,231,219,603</b>	<b>-460,475,555</b>	<b>1,127,653,696</b>
	<b>Rritja (+) Renia (-) neto e mjeteve monetare</b>	<b>39,415,776</b>	<b>466,679,204</b>	<b>20,008,331</b>
	<b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>	<b>499,277,533</b>	<b>32,598,329</b>	<b>12,589,998</b>
	<b>Efakti kurseve te kembimit</b>			
	<b>Mjete monetare ne fund te periudhes kontabile</b>	<b>538,693,309</b>	<b>499,277,533</b>	<b>32,598,329</b>

Pasqyrat financiare duhet te lexohen se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri ne 28, te cilat jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.

**A d m i n i s t r a t o r i**

ARBEN MARGILAJ

*Arben Margilaj*  
*[Signature]*

**Hartues i pasqyrave financiare**

AURORA CULLUFE

*Aurora Cullufe*  
*[Signature]*

## **V- SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

### **1. Informacion i pergjithshem**

Shoqeria "ENER TRADE" SHPK eshte themeluar ne date 12.09.2018 dhe eshte regjistruar ne QKB me daten 18.09.2018.

Selia e Shoqdrise ndodhet ne Rruga e Elbasanit, Objekti Park Gate, Kati I, Tirane.

NIPT-i i Shoqdrise eshte L82118017S

Perfaqesuesi ligjor i i shoqerise eshte Z. ARBEN MARGILAJ.

Aktiviteti kryesor I kesaj shoqerie eshte: Veprimtari ne sektorin e energjise elektrike. Import, eksport, tregtim te energjise elektrike. Shitje dhe blerje te energjise elektrike brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Çdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Veprimtaria e Shogerise rregullohet me Ligjin Nr.79901 date 14.04.2008 "**Per tregtetaret dhe shoqerite tregtare**", i ndryshuar.

Kapitali i Regjistruar i shoqerise me 31.12.2021 eshte **40,000,000** leke i perbere nga 2 kuota me vlere 20,000,000 lek secila te cilat zoterohen nga Ortaket Gjonaj Group Holdings person juridik regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT M22010013H dhe Z.Artur MICKAJ, ashtu sic eshte deklaruar dhe regjistruar ne QKB me numer te ceshtjes CN-727612-06-21.

Numri i te punesuarve deri me 31.12.2022 eshte 13 punonjes, nga 11 punonjes qe ishin ne vitin 2021. Drejtimi i shoqerise realizohet nga Z. Arben MARGILAJ Administrator.

### **2. Aplikimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar te reja dhe te rishikuara (SNRF).**

#### **2.1. Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale**

Ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i leshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK), jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **Ndryshime ne SNK 7 "Pasqyra e Levizjes se Parase"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 Janar 2020),
- **Ndryshime ne SNK 12 "Tatimi mbi te Ardhurat"** Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per humbjet e parealizuara (efektive per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 Janar 2020),
- **Ndryshime ne SNRF 12 si pasoje e "Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2014-2018)"** rezultuar

nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me nje pikepamje per te eliminuar mosperputhjet dhe per te qartesuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do te jene te aplikueshme per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates I Janar 2020).



2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te pa pervesuara

Ne daten e publikimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e reja te meposhtme, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- *SNRF 9 "Instrumentet financiare",*
- *SNRF 15 "Te ardhurat nga kontratat me klientet dhe ndryshime te metejshme",*
- *SNRF 16 "Qirate",*
- *Ndryshimet ne SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"*
- *Ndryshimet ne SNRF 9 "Instrumentet Financiare"-* Vecorite e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv me ose pas dates 1 Janar 2020),
- *Ndryshimet ne SNRF 10 "Pasqyrat Financiare to Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet ne pjesemarrje dhe sipermarrjet e perbashketa" -* Shitja apo Kontributi i aseteteve mes nje Investitori dhe bashkepunetoreve te tij, ose sipermarrje te perbashketa dhe ndryshimeve te metejshme,
- *Ndryshimet ne SNK 28 "Investimet ne pjesemarrje dhe sipermarrjet e perbashketa"-* interesa afatgjate ne Pjesemarrje dhe Ndermarrje to Perbashketa (efektiv pas dates 1 Janar 2020),
- *Ndryshimet ne SNK 40 "Aktivet Materiale Afatgjata te Investuara" -* Transferimet e aktiveve materiale afatgjata te investuara
- *Ndryshime ne SNRF 1 dhe SNK 28 si pasoje e "Permiresimeve te SNRF-ve*
- *Ndryshimet ne standardet e ndryshme "Permiresimet ne SNRF-te (cikli 2015-2020)"*
- *KIRFN 22 "Transaksionet valute dhe Konsiderata per avancat"*
- *KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi to Ardhurat"*

Shoqeria ka zgjedhur te mos aplikojte kato standarde te reja dhe ndryshime ne standardet ekzistuese perpara dates kur ne kete shoqeri filloi zbatimin e SNRF (01.01.2020). Shoqeria parashikon qe adoptimi i ketyre standardeve dhe ndryshimet ne standardet ekzistuese nuk do te kene ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

### **3. Bazat e pergatitjes se pasqyrave Financiare**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve te publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare ("LERIC") te IASB.

Pasqyrat financiare jane pergatitur duke perdorur bazat e vleresim it te specifikuara nga SNRF per çdo klase te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave gjithperfshirese. Bazat e matjes pershkruhen ne detaje ne politikat kontabel te meposhtme.

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabel. Gjithashtu kjo kerkon qe drejtimi te perdore gjykimin e tij ne procesin e perdorimit te politikave kontabel te Shoqerise. Fushat qe perfshijne nje nivel te larte gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet jane te rendesishme per pasqyrat financiare paraqiten perkatesisht ne shenimet.

Pasqyrat financiare jane pergatitur per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2022. Te dhenat aktuale ne keto pasqyra financiare jane te shprehura ne LEK.

#### **3.1 Deklarata e pajtueshmerise.**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

### **3.2. Biznesi ne vijimesi**

Pasqyrat financiare te Shoqerise pergatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

### **3.3. Krahasueshmeria**

Informacioni krahasues paraqitet ne menyre te vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabel te Shoqerise dhe duke u bazuar ne modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar.

### **3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne monedhen Lek Shqiptar ("Lek"), e cila eshte monedha funksionale e Shoqerise.

### **3.5. Vleresime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe manaxhimit te shoqerise te kryeje vleresime dhe supozime qe ndikojne shumtat e raportuara te aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerite per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Ne disa raste manaxhimi mbeshtetet ne mendimet e eksperteve te pavarur. Manaxhimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen. Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale. Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte:

#### **3.5.1. Zhvleresimi i llogarive te arketueshme**

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pa mundesia e konsumatoreve per te paguar detyrimet e tyre. Keto vleresime bazohen ne moshen e llogarive te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne çregjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te konsumatoreve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses se konsumatoreve. Manaxhimi vlereson ne fund te çdo periudhe ne rast se ka nevojte per zhvleresimin e llogarive te arketueshme.

#### **3.5.2. Provizionet**

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e konflikteve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te nje detyrimi aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%, ne te tilla raste shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatit e ceshtjes. Manaxhimi vlereson ne fund te çdo periudhe ne rast se ka nevojte per krijimin e provizioneve.

#### **3.5.3 Zhvleresimi i inventareve**

Shoqeria vlereson gjendjet e inventarit ne qarkullim te ulet dhe ne inventarin i cili ka humbur vleren e perdorimit per shkak te zhvillimeve teknologjike apo arsyeve te tjera, me synim per te percaktuar masen e zhvleresimit te inventarit, bazuar ne perdorimin e ardhshem te tij dhe ne llogaritjen e vleres neto te

realizueshme. Ne rastet kur vlera neto e realizueshme eshte me e ulet se vlera kontabel neto , ekziston nje tregues qe inventari eshte zhvleresuar. Shoqeria perdor gjykimin e saj (çmuarjen) per te percaktuar masen e zhvleresimit.

### **3.6 Politikat Kontabel**

Politikat kontabel te mepostme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

#### **3.6.1. Transaksionet ne monedhe te huaj**

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31.12.2022 dhe me 31.12.2021 eshte detajuar si me poshte:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
- EURO/LEK	114.23	120.76
- USD/LEK	107.05	106.54

#### **3.6.2. Instrumentat financiare**

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena dhe llogari te pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to, pervec siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte neperrnjete fitimlumbjes, kostot e transaksionit kalojne ne pasqyren e to ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare jo-derivative maten sic pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore to aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

#### **Mjetet monetare**

Mjetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, mjetet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

### **Llogari te arketueshme**

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive to interesit.

### **Llogari te pagueshme.**

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Per llogarite e pagueshme , te papaguara dhe te pakerkuara per me shume se pese vjet , per te cilat shoqeria, bazuar ne te dhenat dhe komunikimin me palen tjetere nuk ka ndonje pritshmeri per shlyerjen e ketyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e mesiperme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si te ardhura te vitit kur behet fshirja e tyre.

### **Hua te marra dhe te dhena.**

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht dhe mbahen ne vazhdim me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve cdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar (si rregull) ne interesin efektiv. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perlllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

### **Vlera e drejte.**

Vlerat e drejta te perlllogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per fu paguar dhe huave, perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

### **Te tjera**

Instrumenta te tjere jo-derivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur c do humbje nga zhvleresimi.

### **Zhvleresimi i aktiveve financiare**

Nje aktiv financiar konsiderohet qe ka pesuar nje renie ne vlere nese ka evidence objektive qe tregon se nje ose disa ngjarje kane pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare te ketij aktiviti. Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se tij kontabel dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen origjinale efektive te interesit.

Aktivet financiare te rendesishme testohen per renie ne vlere mbi baza individuale. Aktivet financiare te mbetura vleresohen ne grupe qe ndajne karakteristika te ngjashme ne lidhje me rreziqet kredituese. Te gjitha humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Nje humbje nga renia ne vlere rimerret nese rimarrja mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje qe ndodh pasi humbja eshte njohur. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **4. Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vleren nominale te aksioneve.

##### **4.1. Inventaret**

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke perdorur koston e tyre historike dhe perfshirjen e te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Gjendjet e inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike.

##### **4.2. Aktive afatgjata materiale**

###### *a.- Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vetendertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Programi i blere qe eshte pjese perberese ne funksion te nje pajisjeje eshte kontabilizuar si pjese e pajisjes.

Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

###### *b.-Kostot e mepasshme.*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### *c.-Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve Afatgjate Materiale (AAM) llogaritet mbi vleften e mbetur sipas jetes se vleresuar te çdo pjese te aktiviteti afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes, Jetegjatesia e vleresuar per vitin 2022 dhe 2021 eshte si me poshte:


**Kategoria e aktiveve**

**Metoda e amortizimit**

**Norma e Amortizimit**

Toka

-



Ndertesa	Vlefta e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlefta e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlefta e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlefta e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlefta e mbetur	25%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohet per zhvleresim kur ngjarje apo ndryshime ne rrethanat qe tregojne se vlera kontabel mund te mos jete e rikuperueshme. Nese ekziston ndonje tregues i tille kur vlera kontabile tejkalon vleren e rikuperueshme te vleresuar, aktivet paraqiten me vleren e tyre te rikuperueshme, e cila eshte me e larta mes vleres se tyre te drejte minus kostot per shitje dhe vleres se tyre ne perdorim. Amortizimi nuk aplikohet per token dhe punimet ne proces qe nuk jane ne funksionim.

### **c.-Çregjistrimi.**

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.

Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjenjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

### **4.3. Aktivet afatgjate jo-materiale**

Nje aktiv jo-material njihet neqoftese :

Eshte e mundeshme qe perfitime e pritshme ekonomike ne te ardhmen te cilat i atribuohen atij aktiv do te rrjedhin tek njesia ekonomike, dhe kosto e aktivit mund te matet me besueshmeri.

Njesia ekonomike vlereson mundesine e perfitimeve te pritshme ekonomike duke perdorur supozime te arsyeshme dhe te mbeshtetura qe perfaqesojne vleresimin me te mire te drejtimit te kompletit te kushteve ekonomike qe do te ekzistojne gjate jetes se dobishme te aktivit.

Aktivitet afatgjate jo-materiale njihen fillimisht me Koston me koston historike te tyre. Mbas njohjes fillestare nje aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje te akumuluar nga zhvleresimi

Amortizimi i aktive jo-materiale llogaritet ne menyre lineare me 15% mbi koston historike.

### **4.4. Aktivet jo-financiare**

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te shoqerise, pervec inventarit dhe tatimit te shtyre, jane rishikuar ne daten e raportimit per te percaktuar nese ka ndonje tregues per renie ne vlere. Nese nje tregues i tille ekziston atehere matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nje humbje nga renia ne vlere njihet nese vlera kontabel eshte me e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e nje aktiviteti eshte vlera me e madhe mes vleres ne perdorim dhe vleres se tregut minus kostot e shitjes. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen me nje norme skontimi para tatimi qe reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe ne rreziqet specifike qe lidhen me aktivin.

Humbjet nga renia ne vlere te njohura ne periudha te meparshme vleresohen ne cdo date raportimi per ndonje tregues rreth zvogelimit ose eliminimit te humbjes. Nje humbje nga renia ne vlere rikthehet nese ka pasur nje ndryshim ne treguesit e perdorur per te percaktuar vleren e rikuperueshme. Nje humbje nga renia ne vlere

rimerret vetem ne masen ne te cilen vlere kontabel e aktivitet nuk e kalon vleren e aktivitet qe duhej te percaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvleresimi, nese asnje humbje nga renia ne vlere nuk do te ishte njohur.

#### **4.5. Kosto e huamarrjes.**

